



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithëshme
Zyra e Prokurimit



02 Nr. 400 - 55165
21/09/2018

Shkresë	12/09/2018
Nga:	Zyra e Prokurimit MENSUR GLAVIĆ
Te:	"LIMORA SHPK" NNSH "SARS", NNP "NDËRTIMI"
Lënda:	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik, Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht Neni 108/A pika 10.1 dhe Rregullave për parashtrimin e kërkesës për Ri-shqyrtim të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit, nxjerrë:

Vendim

1. Refuzohet kërkesa për Ri-shqyrtim të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues : Ndërtimi i stadionit të qytetit-Faza e dyte(Projekt trevjeqar) si e pabazuar dhe
2. Vazhdohet me procedurën e prokurimit.

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim është i bazuar në gjendjen reale të zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Arsyetim :

- a) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 1. Nuk është respektuar Neni 1 pika 1 e LPP nuk qendrojnë për arsye se është respektuar parimi i efikasitetit dhe transparencës në shfrytëzimin e fondeve publike dhe është shpallur fitues tenderuesi i cili ka plotësuar kriteret e percaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit.
- b) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 2. Nuk është respektuar Neni 6 pika 1 e LPP-se nuk qendrojnë për arsye se është për fitues është rekomanduar tenderuesi me çmim më të ulët dhe i përgjegjshëm.
- c) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 3. Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 e LPP-se nuk qendrojnë sepse është respektuar parimi i trajtimit të barabart, jo-diskriminues dhe transparent ndaj të gjithë OE-ve.
- d) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 4. Nuk është respektuar Neni 59 pika 1 dhe 2 e LPP-se nuk qendrojnë sepse komisioni vlerësues gjatë vlerësimit ka qenë objektiv, transparent dhe i paanshëm ndaj të gjithë OE-ve.
- e) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 5. Nuk është respektuar Neni 60-Kriteret e dhenies nuk qendrojnë sepse për fitues është rekomanduar tenderuesi i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.
- f) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 6. Nuk është respektuar Neni 68 Gjendja

ekonomike dhe financiare, pra kushti ne pjesemarrje, Neni III.2.3.i Njoftimit per kontrate nuk qendrojne sepse Deklarata tatimore vjetore e prezentuar ne Dosjen e Tenderit ka arritur vleren e kerkuar prej 3.000.000,00 € per 3 vitet e shkuara e cila dokumentohet edhe nga Administrata Tatimore e Kosoves.

- g) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 7. Nuk eshte respektuar Neni 69 nuk qendrojne sepse lista e kontratave te natyres se ngjashme e prezentuar nga tenderuesi I rekomanduar I ploteson kriteret e publikuara ne Njoftimin e Kontrates dhe Dosjen e Tenderit. Gjithashtu edhe pse ne DT jane futur referencat dhe kontratat e punes per realizimin e puneve te natyres se ngjashme edhe per vitit 2011, 2012, 2013 dhe 2014, te njejtat nuk jane marre parasysh nga komisioni vleresues.
- h) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 8. Nuk eshte respektuar Neni 69 nuk qendrojne sepse Udheheqesi I punishtes se OE te rekomanduar per fitues eshte bachelor, drejtimi konstruktiv me 5 vite pervoje pune dhe ka deshmi se ka menaxhuar projektet te natyres se ngjashme si p.sh. Ndertimi I objektit afarist banesor ne vlere prej 2.426.031,00 €.
- i) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 9. Nuk eshte respektuar Neni 26 I Udhezimit Operativ nuk qendrojne sepse ju si OE keni ofruar nje liste referencave te natyres se ngjashme e cila as per se afermi nuk e arrin vleren e kerkuar ne Njoftimin per kontrate dhe Dosje te Tenderit. Gjithashtu deshmitet e ofruara nga ana juaj nuk e arrijne vleren e kerkuar prej 2.000.000,00€.
- j) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 10. Nuk eshte respektuar Neni 39 pika 3 e Udhezimit Operativ nuk qendrojne per arsye deshmitet e ofruara ne Dosjen e Tenderit nuke arrijne vleren e kerkuar dhe komisioni vleresues nuk ka pare ndonje arsye shitesë per te kerkuar sqarime shitese.


Ne rast se pala e interesuar nuk eshte e kenaqur me vendimin e marr nga autoriteti kontraktues ne fjale mund te parashtroj ankese prane OSHP-se

Me respekt

KOMUNA E DRENAS-IT – ZYRA E PROKURIMIT

Ankesë kundër Njoftimit për dhënies së tenderit:

Me nr.të prokurimit: 611 – 18– 065 - 511



Me emrin: **NDËRTIMI I STADIONIT TE QYTETIT – FAZA E DYTË**

(shëno titullin e kontratës si në paragrafin II.1 të Dosjes së Tenderit)

të iniciuar nga: **KOMUNA DRENAS-IT - ZYRA E PROKURIMIT PUBLIK**

(shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

në afatin ligjor parashtroj këtë:

KËRKESË PËR RI-SHQYRTIM

1. Identifikimi i ankuesit

"LIMORA" sh.p.k & N.N."NDËRTIMI" & N.N.SH."ISARS"

(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

PRISHTINE

(Adresa)

PRISHTINE

(Vendi)

10000

(Kodi Postal)

049492998

(Numri i telefonit)

601582142

(Numri i faksit)

Mimoza MORINA- VESELI

(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Limora.shpk@hotmail.com

(adresa elektronike)

10/09/2018

(data e parashtrimit të ankesës)



(nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____ / _____	
(emri i avokatit)	
_____ / _____	
(adresa e plotë)	
_____ / _____	_____ / _____
(numri i telefonit)	(numri i faksit)
_____ / _____	
(adresa elektronike)	
_____ / _____	_____ / _____
(data e parashtrimit të ankesës)	(nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. B05 Njoftimi për kontratë - me datë 14/06/2018
2. B12 Hapja e ofertave me datë 31/07/2018
3. B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar 06/09/2018
4. B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së 06/09/2018
5. Kërkesë për qasje në dokumentacionin e tenderit 06/09/2018

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☒

Jo

☐

Ofertat janë hap me datë 31/07/2018 – PA VËREJTJE

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po

☐

Jo

☐

Përmes E-mail-i kemi pranuar B42 Letër standard për tenderuesin e eliminuar dhe B58 Njoftimi mbi vendimin për dhënie ka qenë i ngutshëm dhe pa kriteret e Ligjit të prokurimit.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nga qasja që i kemi bërë dokumentacionit të rekomanduar për Fitues, kemi ardhë në përfundim që ZP – Drenas ka bërë një varg shkeljesh.

1. Neni 1 Qëllimi i Ligjit
2. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 Barazia dhe trajtimi / Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.
4. Neni 59 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave
5. Neni 60 Kriteret e dhënies së kontratës
6. Neni 68 Gjendja ekeonomike dhe Financiare
7. Neni 69 Aftësia teknike ose/dhe profesionale pik 6.2
8. Neni 69 Aftësia teknike ose/dhe profesionale pik 6.1
9. Neni 26 i Udhëzimit Operativ i prokurimit publik
10. Neni 39 Sqarimi i tenderëve pika 3 e Udhëzimit Operativ dhe
11. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacionet shtesë, pika 1, 2, 3

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Nuk është respektuar **Neni 1 pika 1 e LPP-së**, (Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, keni Rekomanduar për fitues Tenderuesin e përgjegjshëm dhe me çmim fiks **104,960.70 €** më të lartë se Ne si Grup dhe tenderues të përgjegjshëm).
2. Nuk është respektuar **Neni 6 pika 1 e LPP-së**, (Fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, edhe ky nen është shkelur në mënyrë flagrante, sepse nuk keni analizuar ta kurseni paratë publike- buxhetin, por në mënyrë si është vepruar ka ndodhur dëmtim i madh i buxhetit).
3. Nuk është respektuar **Neni 7 pika 1 e LPP-së**, (Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente).
4. Nuk është respektuar **Neni 59 pika 1 dhe 2**, (Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave) sepse komisioni i caktuar ka përgjegjësi individuale dhe si grup të jetë i pa anshëm dhe transparent ashtu si Ju obligon Ligji, dhe Deklaratën nën Betim të cilën e keni nënshkruar.
5. Nuk është respektuar **Neni 60 – Kriteret e dhënies**, (Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët), sepse keni Rekomanduar për fitues Tenderuesin e përgjegjshëm dhe me çmim **104,960.70 €** më të lartë se Ne si Grup dhe si tenderues të përgjegjshëm).
6. Nuk është respektuar **Neni 68, Gjendja ekonomike dhe Financiare, pra kushti në pjesëmarrje, Neni III.2.3**, i Njoftimit për kontratë, Kapaciteti ekonomik dhe Financiar, Dëshmia e kërkuar dokumentare: ku kërkohet: **"Deklaratat Tatimore Vjetore"** të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (mund të nxirren edhe nga veb-faqja e ATK-së por që duhet të vërtetohen dhe nënshkruhen nga OE), që konfirmon se Operatori Ekonomik ka pasur të ardhura bruto për 3 vitet e shkuara prej së paku 3,000,000.00 EURO. Pra të nënshkruhen dhe vërtetohen nga OE apo Grupi OE-ve, **ka qenë kusht i vlersimit**, kështu nuk mund të kërkohen sqarime. Ne i disponojmë dëshmitë, Deklaratat tatimore vjetore të viteve të fundit nga administrata tatimore nuk janë vërtetuar nga asnjëri prej anëtarëve të konzorciumit, siç është kërkuar në bazë të dosjes së tenderit: Pika 8.1 dhe 8.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar.
7. Nuk është respektuar **Neni 69, Aftësia teknike ose/dhe profesionale, është shkelur pika 6 dhe i 6 pika 2 si dhe Neni III.2.4**, e Njoftimit për kontratë **pika 3 apo Pika 9.1 & 9.2 e Dosjes së tenderit**. Është kërkuar Të paraqiten kontratat e

punëve të ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e Njoftimit për kontratë miri. 2,000,000.00 €.

Dëshmitë e kërkuara: Lista e kontratave – origjinal, të natyrës së ngjashme në 3 vitet e shkuara nga data e Njoftimit për kontratë të bashkangjitura me kopjet proceseve, raporteve të pranimeve apo të ngjashme, ku identifikohet qartë, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) nga institucionet shtetërore ose proceset e pranimeve nga ata privat.

Tenderuesit të cilët i keni rekomanduar për fitues, kanë ofruar dëshmi të viteve jashtëligjshme (2011, 2012, 2013, 2014 etj), pra janë kërkuar referenca apo pranime të natyrës së ngjashme në 3 vitet e shkuara nga data e Njoftimit për kontratë.

Pas një pune profesionale dhe pas analizave, gjendja faktike është, kjo: "100 % Design" ka ofruar dëshmi rreth **585,046.94 €**, ndërsa anëtar i tjetër i "Termomontimi" rreth **449,497.53 €** apo së bashku rreth: **1,034,544.47 €**, apo rreth **50% të shumës së kërkuar** (të bashkangjitur e keni Listën e referencave të dy OE të rekomanduar për Fitues). Bashkangjitur gjeni në mënyrë tabelare prezantimi e gjendjes faktike të referencave dhe kontratave të ofruara nga grupi që keni rekomanduar për Kontratë.

8. Nuk është respektuar **Neni 69 Aftësia teknike ose/dhe profesionale**, është shkelë **pika 6 dhe 6.1 (Kushti kryesor) aftësia profesionale e OE sidomos e stafit udhëheqës teknik profesional** që e Menaxhojnë projektin.

Pra është shkelë **Neni III.2.4**, e Njoftimit për kontratë **pika 1 germa b) dhe pika 9.1 & 9.2 germa b)**, në dosje të tenderit ku është kërkuar:

b) Udhëheqës i punishtes: Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose bachelor Drejtimi Konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit si dhe të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekt të ngjajshëm, (rikonstruktim , ndërtim apo renovim të stadiumeve) në vlerë mbi 500,000.00 €. Dëshmia e kërkuar: Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmohet për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëmin e caktuar (rikonstruktim , ndërtim apo renovim të stadiumeve) në vlerë mbi 500,000.00 €.

Tenderuesit të cilët i keni rekomanduar për fitues. Pra Udhëheqësi i punishtes i caktuar me vendim nga partneri i konzorciumin **NN 100% Design, Mentor Hamza, -bachelor i Ndërtimtarisë** i cili në dosjen e tij të ofruar **nuk ka asnjë reference apo përvojë lidhur me ndërtim apo renovim të Stadiumeve**, siç është kërkuar në dosjen e tenderit sipas **pikës:9.1 dhe 9.2 në dosje të tenderit**, Kapaciteti teknik Profesional: **pika b)**, ku kërkohet Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë apo Bachelor drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit si dhe të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekt të ngjajshëm (Rikonstruktim, ndërtim apo renovim të stadiumeve) me vlerë mbi 500,000.00 €.

Pra si keni menduar Ju që një bachelor si **Mentor Hamza**, të udhëheq një projekt të tillë ku do të ballafaqohet me ekspert dhe zyrtar të **UEFA-së**.

9. Nuk është respektuar **Neni 26 i Udhëzimit Operativ faqe 62 pasuesi i fundit**, ku thuhet: "**që operatorit ekonomik gjatë vlerësimit duhet ti ipet rasti të dëshmoj referencat e kërkuar nga AK konform Nenit 69 të LPP-se dhe atë duke i dërguar kërkesë për sqarime dhe t'i ipet një afat por jo më pak se 5 ditë pune.**"

10. Nuk është respektuar **Neni 39 pika 3 e Udhëzimit Operativ**, ku thuhet: "**Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion -**"

tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë se kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të aplikacionit apo të dorëzimit të tenderit. Përveç kësaj, kërkesa nuk do të duhej që të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës", dhe pasuesi i tretë faqe 81, ku thuhet se nëse Lista nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë, duhet të veprohet konform Nenit 72 pika 1,2 dhe 3, pasi që Ne kemi aplikuar si Grup nga 3 operatorë ekonomik dhe dy prej tyre nuk kanë dorëzuar Listë të kontratave, por kanë dorëzuar dëshmi (**kontratat dhe referencat si dëshmi bazike**), dhe për këtë qëllim formohet Grupi, atëherë është dashtë të veprohet Konform Nenit të lartë cekur, sepse as ju por askush tjetër nuk mundet tua humbë përvojën dy partnerëve tjerë në Grup, prandaj për këtë shkak edhe është nxjerre ky Nen.

11. Nuk është respektuar **Neni 72**, Dokumentacioni dhe informacionet shtesë, **pika 1, 2, 3**, pra edhe pse e keni pasë për obligim të kërkonti sqarime, këtë nuk e keni bërë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

1. Humbja e besimit dhe imazhit të kompanisë në vazhdimësi për punët me radhë,
2. Humbja e vendeve të punës për disa punëtor që për momentin janë të angazhuar dhe do ta shtonim numrin e punëtorëve në rast që kjo kontratë do të ishte nënshkruar,
3. Humbja dhe lenia anash e shumë ofertave në pritje për rekomandim të kësaj kontrate për mobilizim në ekzekutim të punimeve,
4. Humbja e tregut për shërbimet që do t'i ofrojmë në rast që do ishim shpallë fitues,
5. Humbja e mjeteve të konsiderueshme financiare nga të cilat kompania do të ecte përpara në afarizmin e vet,
6. Dëmet dhe humbjet materiale qysh nga dita e ofertimit, analizimit, qasjeve në dokumente, analizës së materialit të marr nga ofertuesit, pas qasjes në dokumentet zyrtare e deri të ushtrimit të ankesës pran KK.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtejshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit:

Propoziojmë:

1. Konstatimi i dyshimeve tona siç janë shpjeguar më lartë.
2. Rivlerësimi i ofertave dhe vlerësimi i paanshëm i tyre,
3. Anulimin e vendimit për fituesin e përkohshëm të shpallur me çmim më të lartë se ne ,
4. Marrjen parasysh të ankesës dhe fakteve të dokumenteve tona të dorëzuara, marrjen e vendimit për të na shpallur fitues në "**LIMORA**"sh.p.k & N.N."**NDËRTIMI**"& N.N.SH."**ISARS**" pasi konsiderojmë se i kemi plotësuar kriteret për dhënie.

Pasi nuk keni kërkuar sqarime për dosjen tonë të ofruar e cila konsiderojmë se me se miri dhe për se afërmi ka plotësuar kushtet, duke qene oferta e cila edhe ashtu do ta kursente buxhetin për një shumë të konsiderueshme prej: **104,960.70 €** , dhe pasi keni bërë shkelje të neneve të LPP-së të cekura më lartë, **NE PROPOZOJMË:**

TENDERI TË KTHEHET NË RI-VLERËSIM

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura:

1. B05 Njoftimi për kontratë

2. B12 Procesverbal i Hapjes së ofertave
3. B58 Njoftimi mbi vendimin e AK
4. B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar
5. B46 Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm
6. Kërkesa drejtuar ZP në Drenas për qasje në dokumentacionin e Fituesit
7. Listën e Referencave të "100 % Design" & "Termomontimi" dhe
8. Dëshmitë (Referencat dhe pranimet) e ofrara nga Grupi të udhëhequr nga "Limora" shpk & N.N. "ISARS" & N.N. "NDËRTIMI".

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.